

---

---

**DEBATE SHKENCORE**

---

---

**PETRIT NATHANAILI****FILLESAT E LUFTËS SË PARË BOTËRORE**  
**Diskutime historiografike mbi origjinën e luftës**

Diskutimet rreth origjinës, përmasave dhe pasojave të Luftës së Parë Botërore (LPB) mbeten ende të gjalla tek gjenerata e re e historianëve dhe studiuesve të çështjeve ndërkombëtare. Ato ndër të tjera janë të nxitura edhe nga hulumtimet gjithnjë e më të shumta nëpër arkiva historike në vendet pjesëmarrëse të LPB. Edhe pas 100 vitesh të mbarimit të kësaj lufte, këto diskutime nuk duken se po zbehen, përkundrazi gjallojnë fort mes studiuesve të ndryshëm. Një shekull pas shpërthimit të “Luftës së Madhe”, nuk ekziston ende një konsensus i plotë në mesin e historianëve në lidhje me origjinën e konfliktit, më i madhi që kish parë deri atëherë Evropa dhe bota. E thënë ndryshe, diskutimet historiografike nuk janë mbyllur dhe interpretime të reja, të mbështetur dhe në zbulime të "burimeve të reja" arkivore, mbeten ende të mprehta midis historianëve.

Pas debateve të zhvilluara në vitet 1960 e 1970, të shkaktuara nga libri i historianit gjerman *Fritz Fischer*<sup>1</sup> "Qëllimet Luftës së Gjermanisë perandorake 1914-1918", ribotuar përsëri më 2013, ky diskutim mendohej i mbyllur. Fischer në fillim të viteve 1960 nxori tezën e diskutueshme se përgjegjësia për shpërthimin e LPB ishte vetëm e Gjermanisë perandorake. Në këtë libër mjaft të njohur tashmë, profesor Fischer\* pretendonte se Gjermania imperialiste me anë të luftës synonte të fitonte statusin si fuqi botërore. Për shumicën e gjermanëve mund të mendohej dhe të pranohej se Gjermania kishte shkaktuar Luftën e Dytë Botërore, por aspak Luftën e Parë Botërore, e cila konsiderohej gjerësisht si një luftë që iu imponua Gjermanisë së rrethuar nga armiqtë e saj. Fischer ishte historiani i parë gjerman që botoi dokumente që tregojnë se

---

<sup>1</sup> Fritz Fischer, *Der Griff nach der Weltmacht: Die Kriegszielpolitik des kaiserlichen Deutschland 1914–1918*, Düsseldorf: Droste Verlag, 1961.

\* *Fritz Fischer* (1908-1999), historian gjerman dhe profesor në Universitetin e Hamburgut, i njohur për analizën rreth shkaqeve të Luftës së Parë Botërore. Ai konsiderohet si historiani më i rëndësishëm gjerman i shek. XX nga *Enciklopedia e Historianëve dhe Shkrimit të Historisë*.

kancelari gjerman *Theobald Bethmann Hollweg* (1909-1917) kishte bërë plane në shtator 1914 (pasi lufta kish filluar) të aneksonte të gjithë Belgjikën, një pjesë të Francës dhe një pjesë të Ruisë. Fischer gjithashtu, sugjeronte se, ka pasur vazhdimësi në politikën e jashtme gjermane nga 1900 deri në Luftën e Dytë Botërore, duke lënë të kuptohet se Gjermania ishte përgjegjëse për të dy Luftërat Botërore.<sup>2</sup>

Nga libri i *Fischer*-it rezultoi një debat i rëndësishëm me përmasa ndërkombëtare dhe një rishqyrtim i dokumenteve historikë origjinalë. Një hendek i thellë u hap mes përkrahësve të Fischer-it dhe kundërshtarëve të tyre duke krijuar dy shkolla mendimi. Në këtë debat shpesh u angazhuan dhe historianë të vjetër, veteranë që kishin marrë pjesë në “Luftën e Madhe”, si *Gerhard Ritter*<sup>\*</sup>, i cili ishte kundërshtari më i rreptë i Fritz Fischer. Si pjesë e kritikës së tij ndaj *Fischer*-it, *G. Ritter* argumentonte se qëllimi kryesor i Gjermanisë, në vitin 1914, ishte për të ruajtur Austro-Hungarinë si një fuqi e madhe dhe politika e jashtme gjermane ishte kryesisht mbrojtëse, ndryshe nga *Fischer* që pohonte se ajo ishte agresive<sup>3</sup>. Ai mendon se *Fischer* ishte jo i drejtë në portretizimin e marrëdhënieve austro-gjermane në korrik të vitit 1914. *Ritter* theksonte se Gjermania nuk bëri presion mbi Austro-Hungarinë, e cila ngurronte të sulmonte Serbinë. Ai argumentonte se shtysa kryesore për luftë e Austro-Hungarisë vinte nga politika e brendshme. Në Vjenë e Budapest ka pasur mëdyshje në lidhje me kursin më të mirë që duhej ndjekur, por nuk ishte presioni gjerman ai që çoi Austro-Hungarinë për të zgjedhur luftën si alternativën më të mirë<sup>4</sup>.

Në analizën e shkaqeve të LPB gjatë shek. XX, ka pasur dallime jo të vogla mes historianëve anglo-saksonë e francezë me homologët e tyre gjermanë. Historianët britanikë, amerikanë dhe francezë në përgjithësi kanë këmbëngulur mbi përgjegjësinë e pamohueshme të Gjermanisë, mbi kundërvëniet imperialiste të viteve 1910 si dhe mbi garën e armatimeve të viteve 1912-1913. Ndryshe nga ata, historianët gjermanë kanë pohuar

<sup>2</sup> John Moses, *Fritz Fischer. The Encyclopedia of Historians and Historical Writing*, edited by Kelly Boyd, Vol. I, Fitzroy Dearborn Publishers, Chicago: 1999, f. 387.

<sup>\*</sup> *Gerhard Ritter* (1888-1967), historian nacionalist-konservator gjerman dhe profesor i historisë në Universitetin e Freiburgut.

<sup>3</sup> Gerhard Ritter, "Anti-Fischer", (f. 135-142), from *The Outbreak of World War I*, edited by Holger Herwig, Boston: Houghton Mifflin: 1997, f. 135-136.

<sup>4</sup> Po aty, f. 137.

për një kohë të gjatë se Rusia në marrëveshje me Francën, kishin thurur një komplot kundër sigurisë së Rajhut gjerman, komplot me të cilin u bashkua edhe Britania pas krizës në Agadir në vitin 1911. Për historianët gjermanë, procesi i rrethimit të Gjermanisë nga fuqitë e tjera të mëdha konsiderohet i përfunduar më 1914, si pasojë e bisedimeve rreth një marrëveshjeje detare ruse-britanike, të cilat gjermanët i pikasën në maj 1914, në sajë të një spiuni të vendosur në ambasadën ruse në Londër. Sipas mendimit të historianëve gjermanë, mobilizimi i përgjithshëm i Rusisë më 31 korrik 1914 - e bëri luftën të pashmangshme<sup>5</sup>.

Shumica e historianëve gjermanë mbetën të bindur për vërtetësinë e kësaj qasjeje deri në vitet 1960. Më pas, lindi polemika e përmendur tashmë rreth studimeve të *Fritz Fischer*. Historiani nga Hamburgu, me librin e tij "Qëllimet e Luftës së Gjermanisë perandorake 1914-1918", ngjalli zemërimin e shumë kolegëve të tij, duke pretenduar se Gjermania u përgatit me vetëdije dhe shkaktoi luftën e 1914-ës për të realizuar planet dhe qëllimet e saj imperialiste. Kaq të ashpra ishin këto reagime ndaj *Fischer*-it në Gjermani, sa që historiani francez *Jacques Droz*, në parathënien e botimit të këtij libri për lexuesin francez më 1970, i krahason këto debate pasionante me të njëjtën shkallë intensiteti polemike si në rastin e "çështjes Dreyfus" në Francë<sup>6</sup>, në vitet 1894-1906.

Në vitet 1990, debati u qetësua pasi u vunë në dukje disa ekzagjerime të *Fritz Fischer*, që lidheshin në mënyrë të veçantë me "numërimin prapësht" (*count-down*) të ngjarjeve që çuan në krizën ndërkombëtare në verën e vitit 1914. Shumica e historianëve, atëherë ranë dakord se ishte qeveria gjermane që shkaktoi konfliktin, jo për arsye që lidhen me agresivitetin e saj ose nga dëshira për të kontrolluar ngjarjet, por për shkak të frikës së saj për të rënë viktimë e një rrethimi imagjinar nga fuqitë e tjera evropiane, si Britania e Madhe, Rusia dhe Franca. Ky interpretim i ri i detyrohet shumë punës së studiuesve jogjermanë, ndër të

<sup>5</sup> Gerd Krumeich, "Dossier L'Été 14: d'un monde à l'autre 1914-2014 - Un siècle d'interprétations et de polémiques historiographiques", *Questions internationales*, no. 68, Paris: Juillet-août 2014, f. 26.

<sup>6</sup> *French Historians 1900-2000: The New Historical Writing in Twentieth-Century France examines the lives and writings of 40 of France's great twentieth-century historians*, edited by Philip Daileader, Philip Whalen, John Wiley & Sons, USA: 2010, f. 175.

cilat janë ato të historianit amerikan *Samuel Williamson*<sup>7</sup>, dhe historianit francez *Georges-Henri Soutou*<sup>8</sup>, i cili thekson rëndësinë e faktorëve social e ekonomik dhe ndikimin e tyre në justifikimin e qëllimeve të palëve ndërluftuese në raport me ato diplomatike, ushtarake apo politike.

Në lidhje me programin e 9 shtatorit 1914 të *reich* kancelarit *Bethmann Hollweg*, të përmendur më lart, i cili njihet me emrin “programi i shtatorit”, profesori i Universitetit të Sorbonnës, *G. H. Soutou* mendon se, ky dokument nuk është një program i mirëfilltë zgjerimi territorial, por kancelari thjesht ka dashur të tregojë në formë hipotezash kuadrin e një plani paqeje që ai mendonte se ishte ende i afërt. “Në fakt aksi kryesor i “programit të shtatorit” nuk është territorial, por ekonomik. Para së gjithash për kancelarin fjala ishte për të vendosur një bashkim doganor në Evropën Qendrore (*Mitteleuropa*, ky term përmendet shpesh në dokument si referencë historike dhe kulturore), bashkim që do të rigruponte rreth Gjermanisë, Austro-Hungarinë dhe Belgjikën, por edhe Poloninë, me qëllim për ta shpëputur nga Rusia”<sup>9</sup>.

Debati, që mendohej i mbyllur, pas polemikave të rreth gjysmëshekull më parë mbi librin e Fischer-it, kohët e fundit u rihap për shkak të studimit të historianit australian *Christopher Clark*, profesor në Universitetin Cambridge. Libri i tij *Sleepwalkers. Summer 1914*<sup>10</sup>: Si Evropa marshoi drejt luftës, i cili ngjalli mjaft debate në rrethet e historianëve në vitin 2013 dhe më pas. Në këtë libër autori shtron çështjen në se Gjermania vërtetë duhet të fajësohet për nisjen e LPB, apo vendet evropiane thjesht hynë qorrazi në të? Libri në një masë të madhe shfaqëson Gjermaninë nga përgjegjësia e luftës dhe vë theksin më shumë tek përgjegjësia e Serbisë, Rusisë dhe Francës në origjinën dhe shpërthimin e luftës. Gjithashtu, studimet e historianit gjerman *Stefan Schmidt* mbi përgjegjësinë e Francës<sup>11</sup> në krizën e korrikut 1914, duke u fokusuar në rolin e Presidentit Raymond Poincaré, si dhe libri i historianit

<sup>7</sup> Samuel Williamson, *Austria-Hungary and the Origins of the First World War*, New York: St. Martin's Press, 1991.

<sup>8</sup> Georges Henri Soutou, *Le Sang et l'Or. Les buts de guerre économiques de la Première Guerre mondiale*, Paris: Fayard, 1989.

<sup>9</sup> Georges Henri Soutou, *L'Europe de 1815 à nos jours*, Paris: Presses Universitaires de France, 2007, f. 165.

<sup>10</sup> Christopher Clark, *The Sleepwalkers: How Europe Went to War in 1914*, New York: Harper Collins, 2012.

<sup>11</sup> Stefan Schmidt, *Frankreichs Außenpolitik in der Julikrise 1914*, Munich: Oldenbourg, 2007.

të ri amerikan *Sean Mc-Meekin* mbi origjinën ruse të Luftës së Parë Botërore<sup>12</sup>, rivlerësuan shumë elementë shpjegues mbi origjinën e luftës, që mendoheshin prej kohësh të shterura.

Në fakt, origjina e LPB ka qenë subjekt i debatit mes historianëve dhe analistëve të çështjeve ndërkombëtare që prej fundit të viteve 1920. Historianët prezantuan dhe rishqyrtuan burimet arkivore në dritën e bindjeve të tyre. Veprat e fundit të sapopërmendura, me gjithë bujën që mund të kenë shkaktuar, sipas mendimit të historianit *Gerd Krumeich*<sup>13</sup>, profesor në Universitetin e Dyseldorfit, nuk kanë kontribuar pothuajse në asgjë të re. Ai është thellësisht i bindur, se vendimet që çuan në Luftën e Parë kryesisht janë për shkak të udhëheqësve gjermanë dhe austro-hungarezë që dëshironin të përfitonin nga vrasja e Arkidukës *Franz Ferdinand* në Sarajevë për të shkatërruar Serbinë dhe "testuar" dëshirën e Rusisë për luftë.<sup>14</sup> *Krumeich* si dhe historianë të tjerë britanikë, francezë dhe amerikanë, theksojnë se punimet e fundit konfirmojnë të gjitha, në thelb, rëndësinë e analizave të historianit francez Pierre Renouvin, realizuar që në vitet 1920-1930 dhe veçanërisht librin e tij "*Les Origines immédiates de la guerre*", botuar vetëm pak kohë pas përfundimit të "Luftës së Madhe". Gjermania dhe Austro-Hungaria, shkruan Renouvin "nuk pranuan zgjidhje tjetër veç përdorimit të forcës; ato vendosën planin me ndërgjegje të plotë, pasi morën në konsideratë me gjakftohtësi të gjitha pasojat e mundshme të vendimit të tyre. Në kuadrin e origjinës imediate të konfliktit, ky është fakti që dominon mbi të tjerët."<sup>15</sup>

Fakti që LPB ishte një luftë mes Fuqive të Mëdha rivale mes tyre, nuk do të thotë se në vetvete shkaqet për konflikt mes palëve ndërluftuese kishin shumë rëndësi dhe se ekspansioni imperialist ishte një arsye për luftë. Realisht kjo gjen mbështetje në analizat e historiografisë bashkëkohore, ku pikëpamjet e historianit amerikan *David Fromkin* janë

<sup>12</sup> Sean McMeekin, *The Russian Origins of the First World War*, Cambridge, Mass.: Belknap Press of Harvard University Press, 2011.

<sup>13</sup> *Gerd Krumeich* - historian dhe profesor emeritus në Universitetin Heinrich-Heine të Dyseldorfit dhe Profesor, nënkryetar i Qendrës Ndërkombëtare të Kërkimeve për Historinë e Luftës së Madhe dhe anëtar i Këshillit Shkencor të Misionit për 100-vjetorin. Argumentet e tij i ka prezantuar në librin "*Juli 1914. Eine Bilanz*", Verlag Ferdinand Schöningh, Paderborn, 2013.

<sup>14</sup> G. Krumeich, "Un siècle d'interprétations et de polémiques historiographiques ...", f. 26.

<sup>15</sup> Pierre Renouvin, *Les Origines immédiates de la guerre: 28 juin-4 août 1914*, Paris: A. Costes, 1925, f. 268.

më përfaqësueset: “Lenini gabohej, shkruan ai. LPB ishte luftë për kontrollin e Evropës kontinentale dhe jo për perandori në Azi dhe Afrikë ... kur mbaroi LPB, dukej qartë se një nga pasojat e saj më 1919, ishte zgjerimi i madh i perandorisë britanike. Disa arritën në përfundimin se kjo kish qenë luftë imperialiste, një luftë për ekspansion imperialist. Ky ishte iluzion. Në gusht 1914, kur *Gray* (ministri i Jashtëm) dhe *Asquith* (kryeministri) e futën Britaninë në luftë, ata nuk kishin dëshirë për ekspansion, dhe nuk ndoqën ndonjë strategji të paravendosur për zgjerim perandorak; ata nuk e futën vendin në luftë me shpresë për të fituar më shumë territore. E njëjta gjë vlen edhe për Gjermaninë ... nuk ishte imperializmi ai që shkaktoi luftën”.<sup>16</sup>

Por, pyetja është se çfarë e shkaktoi luftën? Deri në fund të viteve 1920 ka qenë e modës të mendohej se shkak i LPB nuk konsideroheshin vendimet e shtetarëve dhe qeverive, por ndikimi i sistemeve ose forcave të papërcaktuara... Ky këndvështrim sot nuk mbështetet më nga historianët bashkëkohorë. Përfaqësues të këtij qëndrimi janë dy historianë britanikë, *Hew Strachan* dhe *David Stevenson* që mendojnë se : “ajo që i dallon javët e nxehta të korrikut 1914 nuk është roli i forcave kolektive dhe as faktorët afatgjatë, por individi”.<sup>17</sup> Paqja në Evropë në fillim të shek. XX dukej se ishte si një shtëpi kartoni, që çdo kush mund ta shembte. Kriza ndërkombëtare e verës së 1914-ës, “mendohej si shembulli klasik i një lufte që fillonte krejt rastësisht dhe për më tepër gabimisht, të cilën asnjë shtetar nuk e dëshironte, por fatkeqësisht ata u gjendën nën presionin e madh të një zinxhiri ngjarjesh që dolën jashtë kontrollit. Por, kjo pikëpamje sot nuk qëndron më”.<sup>18</sup> Pra, kush e shkaktoi LPB dhe përse mund të pyes me të drejtë kushdo? *David Stevenson*, profesor i historisë ndërkombëtare në *LSE (London School of Economics and...)*, shprehet se “çelësi për të kuptuar shkatërrimin e paqes duhet kërkuar në Berlin ... Gjermania dëshironte një luftë lokale mes Austrisë dhe Serbisë, por qëllimisht rrezikoi një luftë kontinentale kundër Francës dhe Ruisë, dhe përfundimisht filloi atë”.<sup>19</sup> Gjithashtu, edhe mes

<sup>16</sup> David Fromkin, *Europe's Last Summer: Why the World Went to War in 1914*, London: Heinemann, 2004, f. 278.

<sup>17</sup> Cituar nga Nigel Biggar, *In Defence of War*, UK: 2013, Oxford University Press, f. 131.

<sup>18</sup> David Stevenson, *1914-1918. The History of the First World War*, London: Penguin, 2004, f. 41.

<sup>19</sup> *Po aty*, f. 590.

studiuesve që merren me studimin e çështjeve të sigurimit ndërkombëtar, ka një mirëkuptim për ta konsideruar si të padrejtë mendimin se shpërthimi i LPB ishte thjesht një gabim trashanik (*blind blunder*).<sup>20</sup>

Në gjirin e historianëve dhe studiuesve të çështjeve ndërkombëtare sot ka një konsensus rreth një versioni të modifikuar të tezave *Fischer* të viteve 1961-1969. Por, ky konsensus ndryshon në dy aspekte nga tezat e *Fischer-it*: i pari, është se Gjermania në të vërtetë nuk vendosi të futet në luftë duke u bazuar në atë që njihet si “Këshilli i Luftës i 8 dhjetorit 1912”; dhe së dyti, motivi i saj për t’u futur në luftë në verën e 1914-ës nuk ishte ekspansioni imperialist dhe dominimi botëror, siç e tregonte dhe titulli origjinal i librit të *Fischer-it*, por më tepër ruajtja e pozitës së saj drejtuese në Evropë. Konsensusi vjen si nga historianë britanikë (*Stevenson*) ashtu dhe nga historianë amerikanë (*Fromkin*), por ai zgjerohet edhe me shumë historianë gjermanë. “Megjithëse libri i parë i *Fischer-it* i qëndroi më mirë kritikës, ai ekzagjeronte unanimitetin në gjirin e elitës berlineze dhe nënvlerësonte ngjashmëritë midis synimeve të luftës së Gjermanisë me ato të Fuqive të Antantës. Shumica e historianëve gjermanë e kanë pranuar vlerësimin e *Fischer-it* mbi rolin e Gjermanisë në krizën e korrikut, dhe shumica e analizave të tij mbi qëllimet e luftës së Gjermanisë kanë rezistuar pa u kundërshtuar”.<sup>21</sup>

Në një studim voluminoz, “Great War in History: Debates and Controversies 1914 to the Present”, shkruar nga dy historianë, një amerikan dhe një francez, *Jay Winter & Antoine Prost*, dy figura kryesore të historisë sociale dhe kulturore të LPB, spikat një analizë e plotë krahasuese e shkrimit të historisë së LPB. Ky studim ndërdisiplinor në qasjen e tij, i kushtohet historiografisë politike, ushtarake, ekonomike, sociale dhe kulturore të LPB. Që nga armëpushimi i vitit 1918, një literaturë e gjerë është prodhuar mbi LPB dhe pasojat e saj. Në këtë libër, botuar nga Universiteti i Cambridge më 2005, dy historianë kryesorë nga Shtetet e Bashkuara dhe Franca kanë prodhuar një analizë të plotë krahasuese të mënyrave në të cilat kjo histori është shkruar dhe interpretuar. Libri identifikon tre breza historianësh, studiuesish letrarë dhe shkrimtarë të cilët kanë komentuar luftën. Nëpërmjet një strukture tematike, vlerësohen jo vetëm studimet diplomatike dhe ushtarake, por edhe interpretimet sociale dhe kulturore të “Luftës së Madhe”, dhe se si

<sup>20</sup> Nigel Biggar, *In Defence of War*, UK: Oxford University Press, 2013, f. 132.

<sup>21</sup> D. Stevenson, *1914-1918. The History of the First World War ...*, f. 591.

ajo është shikuar kryesisht nga shkrimtarë francezë, gjermanë dhe britanikë. Ky është një studim rasti interesant i praktikës së historisë në shekullin e njëzetë dhe evidenton rëndësinë e optikës kombëtare në formësimin e narrativës historike. Ky libër interesant është një burim i çmuar për dijetarët dhe studiuesit e historisë, të studimeve mbi luftën, historisë evropiane dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Winter & Prust e vlerësojnë punimin e Fischer-it “si një interpretim me forcë të madhe morale, që nuk të habit për një njeri që është arsimuar në teologji”.<sup>22</sup> Megjithatë, konsensusin mbi shkaqet e LPB, Winter & Prust e shohin kryesisht si një rikthim në pozitën e historianit francez të viteve 1920. 70 vjet pas analizës së *Renouvin* mbi këtë çështje<sup>23</sup>, Winter & Prust komentojnë se “ne sot i kthehemi plotësisht qëndrimit të tij, botuar vetëm 5 vjet pas fundit të konfliktit. Nuk mund të mos admirosh se sa akademik dhe i kujdesshëm u tregua ai dhe sa mirë i qëndruan sprovës së kohës përfundimet e tij”.<sup>24</sup> Në një studim mbi krizën dhe luftën 1914-18, *Renouvin* argumentonte se pasi t’i kemi thënë dhe bërë të gjitha, ne duhet të kërkojmë për një shpjegim më të plotë të shkaqeve të shpërthimit të luftës në politikën dhe në veprimin e qeverive. “Ky shpjegim [*i mjaftueshëm*], qëndron në orientimin e politikave kombëtare dhe në veprimin e qeverive dhe vetëm këtu duhet ta kërkojmë atë”<sup>25</sup>, përfundon ai në studimin e tij.

Pas LPB, në Gjermani ka pasur një polemikë mjaft të mprehtë lidhur me *Kriegsschuldfrage* (çështja e fajit të luftës, apo përgjegjësisë), një debat publik që u zhvillua në lidhje me përgjegjësinë e Gjermanisë në shpërthimin e konfliktit të parë botëror. Gjatë nënshkrimit të Traktatit të Versajës më 1919, për herë të parë në histori, fituesit e luftës vendosën të formulonin një dispozitë (neni 231 i traktatit), ku humbësit e LPB të pranonin përgjegjësinë e tyre të plotë dhe të vetme për shpërthimin e saj. Ky nen ka shërbyer si një bazë ligjore për të detyruar Gjermaninë të paguajnë dëmshpërblime. Neni 231 ishte një nga pikat më të diskutueshme të Traktatit të Versajës. Aty shprehet se “Qeveritë Aleate dhe të bashkuara deklarojnë, dhe Gjermania pranon, se Gjermania dhe

<sup>22</sup> Jay Winter & Antoine Prost, *Great War in History: Debates and Controversies 1914 to the Present*, Cambridge University Press: 2005, f. 47.

<sup>23</sup> Për këtë çështje shih shënimin nr. 17.

<sup>24</sup> J. Winter & A. Prost, *Great War in History* ..., f. 40.

<sup>25</sup> Pierre Renouvin, *La crise européenne et la grande guerre 1914-1918*, Paris: Felix Alcan, 1934, f. 180.

aleatët e saj janë përgjegjëse për të gjitha humbjet dhe dëmet e pësuar nga Qeveritë Aleate dhe të Bashkuara dhe nga qytetarët e tyre për shkak të luftës që iu imponua atyre me sulmin e Gjermanisë dhe të aleatëve të saj”.<sup>26</sup> Në Gjermani këtë dispozitë e konsideruan si poshtërim kombëtar, që detyronte Gjermaninë të pranonte përgjegjësinë e plotë për shpërthimin e luftës.

Konsensusi historik është se përgjegjësia apo faji i luftës nuk ishte i lidhur me nenin 231. Dispozita shihej si një parakusht për të mundësuar krijimin e një baze ligjore për pagesat e riparimeve që duhej të bëhen. Historianët evidentuan dëmet e paqëllimshme të krijuara nga dispozita, e cila shkaktoi zemërim dhe pakënaqësi tek populli gjerman, i cili e quajti atë Diktat. “Që prej asaj kohe dhe për një kohë të gjatë, historia e kësaj periudhe u bë goftë për të provuar drejtësinë e hartuesve të traktatit, goftë për të treguar se e drejta e më të fortit nuk përcakton *ipso facto* të vërtetën historike. Rrallëherë historia është vënë kaq hapur dhe tërësisht në shërbim të politikës”.<sup>27</sup> Në se marrim në konsideratë që Lufta e Dytë Botërore duket si një rezultat i zhvillimit të Luftës së Parë, mund të mendojmë se “çështja e fajit të luftës” *Kriegsschuldfrage*, mbeti e rëndësishme dhe mjaft e diskutueshme në shoqërinë gjermane, pasi ajo u bë një nga temat e preferuara të propagandës së Hitlerit për ardhjen e tij në fuqi dhe nxitjen e një lufte të re botërore.

“Çështja e fajit” lidhet me një debat tjetër në historiografinë gjermane, *Sonderweg* (gjermanisht: "Rrugë e veçantë" ose veçori), teori që konsideron territoret gjermanofolëse dhe vetë Gjermaninë, se kanë ndjekur një kurs të veçantë në histori, ndryshe nga vendet e tjera evropiane. Ky është një debat që ka qenë veçanërisht i fortë në vitet 1970 dhe 1980 dhe që thekson një veçori të pretenduar gjermane. Në veçanti, ithtarët e saj argumentojnë se mënyra se si Gjermania është zhvilluar historikisht, dëshmon për një evolucion të rendit të saj shoqëror dhe politik në përputhje me orientimin që mori Gjermania gjatë periudhës naziste. Sipas pikëpamjes së tyre, mentaliteti gjerman, struktura e shoqërisë, si dhe zhvillimet institucionale kanë ndjekur një kurs të ndryshëm në krahasim me ato të vendeve të tjera të Perëndimit, të cilat kishin një zhvillim normal të historisë së tyre. Historianët si *Fritz Fischer*

<sup>26</sup> Petrit Nathanaili, *Burime të Zgjedhura nga Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*, Tiranë: Albas, 2015, f. 154.

<sup>27</sup> René Girault, *Diplomatie européenne et impérialismes 1871-1914*, Paris: Masson, 1979, f. 215.

dhe *Hans-Ulrich Wehler* argumentonin se, ndryshe nga Franca dhe Britania, Gjermania kishte përjetuar vetëm një "modernizim të pjesshëm", në të cilën industrializimi nuk u pasua nga ndryshimet në sferat politike dhe sociale, të cilat sipas mendimit të *Fischer* dhe *Wehler* vazhduan të dominohen nga një elitë "para-moderne" aristokratike.<sup>28</sup> Gjermania perandorake u bë moderne ekonomikisht, por mbeti feudale në planin politik, sipas gjykimit të *Wehler*-it. Historianët *Hans-Ulrich Wehler* dhe *Wolfgang Mommsen*, mendojnë se në planin ndërkombëtar, frika e rrethimit ishte për Gjermaninë perandorake (1871-1918) një mënyrë për t'u ndarë nga pjesa tjetër e kombeve demokratike të Perëndimit. Megjithëse "kjo tezë e *Sonderweg* gjerman u trajtua gjerësisht në Francë, ajo është kundërshtuar me forcë nga historianët anglo-saksonë, si *Geoff Eley*, *Richard Evans* dhe *Niall Ferguson*. Sot, demokratizimi i Gjermanisë është realizuar plotësisht dhe për rrjedhojë dhe interesi historik dhe politik i kësaj teze po dobësohet edhe në një vend si Franca".<sup>29</sup>

Për rrethanat historike të shpërthimit të LPB çdo lloj analize serioze merr në konsideratë duke i krahasuar një tërësi faktorësh të thellë që mendohen se kanë krijuar një gjendje të përgjithshme tensioni. "Në se më pas do të përpiqemi të përcaktojmë se cili nga këta faktorë është kryesorshkruan historiani René Girault-kjo lidhet me zgjedhje ideologjike se sa me studimin e historisë". Të kërkosh ndër përgjegjësit e kohës "nxitësit e luftës" më karakteristikë vazhdon ai, do të thotë të harrosh se të gjithë këta njerëz kanë qenë thellësisht të bindur se ata i përgjigjeshin reagimit ose provokimeve të kundërshtarëve të tyre dhe se mendonin se ishin të detyruar të kundërpërgjigjeshin; në të njëjtën mënyrë, ata shpeshherë arrinin në përfundimin se lufta ishte e keqja më e vogël dhe se duhej ta çonin deri në fund. Nuk mund të mos biem dakord me përfundimin se në këtë rast studimi të historisë, nuk duhen "kërkuar përgjegjësitë, por shkaqet e kësaj lufte të tmerrshme që i jep fund një bote të caktuar."<sup>30</sup>

Në kuadrin e 100-vjetorit të LPB, në vendet kryesore evropiane pjesëmarrëse në këtë ngjarje tronditëse që hapi historinë e trazuar të shek. XX, perceptimet sot janë krejtësisht të ndryshme. Për francezët dhe

<sup>28</sup> *The Encyclopedia of Historians and Historical Writing*, edited by Kelly Boyd, Volume I-II, Chicago: Fitzroy Dearborn Publishers: 1999, f. 455, 1289.

<sup>29</sup> G. Krumeich, "Un siècle d'interprétations et de polémiques historiographiques ...", f. 28.

<sup>30</sup> R. Girault, *Diplomatie européenne ...*, f. 215-216.

belgët, “Lufta e Madhe” mbetet një element konstituiv i kombit dhe i shtetësisë së tyre. Për të rinjtë gjermanë në të kundërtën, Lufta e Parë Botërore, është një ngjarje sigurisht mjaft e rëndësishme, si Lufta Tridhjetë Vjeçare apo Revolucioni Francez, por që nuk ka të bëjë, pothuajse fare, me historinë e Republikës së tyre të bukur të pas Luftës së Dytë. Për shumë gjermanë në mënyrë të natyrshme, historia fillon më 1945,<sup>31</sup> përfundon profesor Krumeich analizën e tij me një frymë krejt pozitive për këto çështje ende të diskutueshme, jo vetëm mes studiuesve.

### Përmbledhje

Gjenerata e re e studiuesve me hulumtimet e shumta nëpër arkivat, ka rihapur diskutime rreth origjinës dhe pasojave të Luftës së Parë Botërore. 100 vjet pas fundit të luftës, këto diskutime janë ende të gjalla. Rreth një shekull pas shpërthimit të “Luftës së Madhe”, nuk ekziston ende një konsensus i plotë ndër historianët dhe analistët e çështjeve ndërkombëtare në lidhje me origjinën e konfliktit më të madh që kish parë deri atëherë Evropa dhe bota. Debati historiografik nuk është mbyllur dhe interpretime të reja mbështetur edhe në zbulime të "burimeve të reja" arkivore mbeten ende të ndezura midis historianëve. Ky diskutim që mendohej i mbyllur, pas debateve të viteve 1960 dhe 1970 rreth librit të historianit gjerman *Fritz Fischer*, "Qëllimet e Luftës së Gjermanisë perandorake 1914-1918", kohët e fundit u rihap për shkak të studimit të historianit australian *Christopher Clark*. Libri i tij "Sleepwalkers. Summer 1914: Si Evropa marshoi drejt luftës" botuar në vitin 2013, në një masë të madhe shfaqëson Gjermaninë nga përgjegjësia e luftës dhe vë theksin më shumë tek përgjegjësia e Serbisë, Ruisë dhe Francës në origjinën dhe shpërthimin e luftës. Nga libri i *Fritz Fischer* rezultoi një debat i rëndësishëm ndërkombëtar dhe një rishqyrtim i dokumenteve origjinale. Në vitet 1990, debati u qetësua kur u vunë në dukje disa ekzagjerime të *Fritz Fischer*, që kanë të bëjnë në mënyrë të veçantë me “numërimin prapësht” (*count-down*) të ngjarjeve që çuan në krizën ndërkombëtare në verën e vitit 1914. Shumica e historianëve, atëherë ranë dakord se ishte qeveria gjermane që shkaktoi konfliktin, jo për arsye që lidhen me agresivitetin e saj ose nga dëshira për të kontrolluar ngjarjet, por për shkak të frikës së saj për të rënë viktimë e një rrethimi imagjinar nga fuqitë e tjera evropiane, si Britania e Madhe, Rusia dhe Franca. Ky interpretim i ri i detyrohet shumë punës së studiuesve jo-gjerman, ndër të cilat janë ato të historianit amerikan *Samuel Williamson* dhe francezit *Georges-Henri Soutou*. Me vend është për të theksuar se studimet e fundit

---

<sup>31</sup> *Po aty*, f. 28.

konfirmojnë në thelb, rëndësinë e analizës së historianit francez *Pierre Renouvin*, veçanërisht librin e tij *Les Origines immédiates de la guerre*, botuar pak vite pas LPB.